



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No	05-7440
Nr.i faqeve Br.stranica No. pages	-3-
Data: Datum: Date:	11/10/2017
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

NË MES TË

Departamentit Shëndetësor të Burgjeve / Ministrisë së Shëndetësisë

dhe

Organizatës Joqeveritare “Labirint” në Prishtinë

PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL, MONITORIM DHE MBËSHTETJE LIDHUR ME PËRDORIMIN E DROGAVE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE STIGMËN NË BURGJE

Bazuar në nevojat e shërbimeve shëndetësore të burgjeve për trajtimin e përdorimit të drogave, parandalimit të përdorimit të drogave në burgje, trajtimi dhe rehabilitimi i tyre, trajnimi profesional i stafit shëndetësor të burgjeve për trajtim të kësaj çështjeje, analiza e situatës dhe hulumtimet profesionale ne dobi të trajtimit adekuat dhe profesional përmes monitorimit adekuat të drejtave të njeriut të përdoruesve të drogave dhe stigmatizimit të tyre, lidhe këtë marrëveshje:

Neni 1
Qëllimi

1.1 Me këtë marrëveshje mirëkuptimi përcaktohet mënyra e bashkëpunimit në mes të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB), Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe Organizatës Joqeveritare “Labirint” (OJQL), për bashkëpunim profesional, monitorim dhe mbështetje lidhur me përdoruesit e drogave në burgje dhe specifikat si dhe pasojat nga përdorimi i drogave, të drejtat e njeriut dhe stigma.

1.2. Me këtë marrëveshje mundësohet bashkëpunimi i Organizatës Joqeveritare “Labirint” (në tekstin e mëtejme si OJQL), dhe Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në tekstin e mëtejme si DShB) për të arritur qëllimin e kësaj marrëveshjeje sipas pikës 1.1 të këtij neni.

Neni 2
Organet zbatuese të marrëveshjes

2. Me rastin e lidhjes së kësaj marrëveshjeje, organet kompetente të palëve të cilat zotohen për zbatimin e saj janë:
- 2.1. Organizatës Joqeveritare “Labirint” – OJQL, licencuar në MSh për trajtim të drogave,
 - 2.2. Departamentit Shëndetësor të Burgjeve – DShB,

Neni 3

Obligimet e organeve zbatuese të marrëveshjes

3.1. Obligimet e OJQL- së:

- 3.1.1. Ofrimin i mbështetjes së DShB lidhur me menaxhimin e përdorimit të drogave në burgje njëjtë sikurse për qytetarët e tjerë.
- 3.1.2. Analizën, hulumtimin të situatës aktuale, se paku një herë në vit lidhur me specifikat e përdorimit të drogave në burgje.
- 3.1.3. Ndërmarrja e veprimeve të nevojshme profesionale bazuar në të gjeturat eventuale në analizë.
- 3.1.4. Mbështetja e stafit shëndetësor në parandalimin e përdorimit të drogave në burgje, përmes:
 - 3.1.4.1. Monitorimin e mënyrës së qasjes dhe trajtimit të të burgosurve nga ana e stafit mjekësor në burgje,
 - 3.1.4.2. Monitorimi dhe mbështetja në përpilimin e planeve dhe protokolleve për parandalim, trajtim dhe rehabilitim,
 - 3.1.4.3. Monitorimi i të drejtave të njeriut dhe parandalimi i stigmatizimit të përdoruesve të drogave në burgje përmes formave të ndryshme dhe bisedave të drejta për drejta të të burgosurit.
 - 3.1.4.4. Monitorimi i të drejtave të njeriut lidhur me trajtimin shëndetësor të tyre në përgjithësi dhe trajtimin për droga në veçanti.
 - 3.1.4.5. Garantimi i trajnimit të stafit dhe implementimi i proceduarve dhe protokolleve dhe të arriturave më të reja shkencore konform trajtimit të përdoruesve në institucionet publike, publike private dhe private në vend.
 - 3.1.4.6. Mbështesë dhe trajnoj këshillimin dhe testimin vullnetar të rasteve dhe sugjeroj format dhe testet kualitative dhe të kohës.
 - 3.1.4.7. Mbështes dhe trajnoj e monitoroj Mirëmbajtjen dhe Trajtimin me Metadon dhe terapi tjetër zëvendësuese.
- 3.1.5. Mbështetja e DShB për implantimin e programeve parandaluese, të zvogëlimit të dëmit, trajtimit, rehabilitimit të përdoruesve të drogave.
- 3.1.6. Mbështetjen e DShB në aspektin Mediko Psiko terapeutik dhe parandalimin e vetëvrasjeve në burgje përmes formave të ndryshme shkencore dhe profesionale multidisciplinare.
- 3.1.7. Mbështetja dhe lidhshmëria e trajtimit dhe rehabilitimit të përdoruesve gjatë fazës pranimit dhe vazhdimin e trajtimit paraprak si dhe të përgatitjes së lirit dhe pas lirit të tyre me institucione të tjera relevante të vendit.
- 3.1.8. Përpilimi i raporteve periodike sipas aktiviteteve të ndërmarra.
- 3.1.9. Raportet vjetore i dërgohen Drejtorit të DShB në MSh.
- 3.1.10. Vërejtjet dhe rekomandimet si dhe mënyra e menaxhimit të monitorimit dhe trajtimit bëhet sipas planit paraprak të aprovuar nga të dyja palët.
- 3.1.11. OJQL ka mundësinë dhe të drejtat e në çdo kohë, më paralajmërim 24 orë më herët, të bëjë monitorimin e trajtimit të rasteve sipas proceduarve dhe protokolleve në fuqi.

3.2. Obligimet e DShB-së

- 3.2.1. Të mundësoj OJQL-së të veproj në mënyrë profesionale dhe pa pengesa për zbatim të marrëveshjes.
- 3.2.2. Të krijoj kushte adekuate të punës dhe të ofroj në dispozicion dokumentacionin dhe të gjitha çështjet e nevojshme.
- 3.2.3. Të përfillë sugjerimet, rekomandimet dhe të bashkëpunoj në tejkalimin e pengesave dhe vërejtjeve eventuale.
- 3.2.4. Të shqyrtoj dhe përpunoj së bashku raportet vjetore dhe të nxjerr plane dhe analiza lidhur me masat e ndërmarra dhe planet afat shkurtra, afat mesme dhe afatgjata lidhur me çështjen.
- 3.2.5. Të bëjë hulumtime të përbashkëta profesionale dhe shkencore në dobi të analizës së situatës, cilësisë së shërbimeve dhe përfundimet me rekomandime adekuate profesionale obliguese për implementim.

Neni 4 **Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve**

- 4.1. Çfarëdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me diskutime të përbashkëta të palëve të nënshkruara dhe zbatuese të saj.
- 4.2. Marrëveshja zgjatë dy vite, me mundësi vazhdimi.

Neni 5 **Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj**

- 5.1. Kjo marrëveshje mund të modifikohet vetëm me shkrim, me parapëlqimin reciproke të palëve. Çfarëdo ndryshimi i kësaj marrëveshjeje shtohet si aneks i marrëveshjes dhe hynë në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e organeve implementuese të marrëveshjes.
- 5.2. Krahas asaj që parashihet në këtë nen, kjo marrëveshje apo pjesë të saj mund të shfuqizohen apo modifikohen në mënyrë automatike, pa pasur nevojë marrëveshjen e palëve, edhe me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji apo akti tjetër nënligjor dispozitat e të cilit bien në kundërshtim me këtë marrëveshje.
- 5.3. Nëse tentativat për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve nuk kanë sukses, secila nga palët mund të ndërpresë këtë marrëveshje. Njoftimi për ndërprerje të marrëveshjes duhet t'i dërgohet palës tjetër me shkrim, së paku një muaj para ndërprerjes efektive të saj.

Neni 6 **Hyrja në fuqi**

- 6.1. Marrëveshja hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

Për DShB, Ministrinë e Shëndetësisë:

Milazim GJOCAJ


Drejtor i Departamentit



Për OJQ Labirinti:

Përfaqësuar nga:

Safet BLAKAJ


Drejtor Ekzekutiv



Prishtinë: 11.10.2017